

AKTI I THEMELIMIT

(I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR)

Duke u bazuar ne Ligjin Nr.7512,date 10.08.1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private,te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit",ne ligjin Nr. 7632,date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te kodit tregtar";ligjin Nr.7638,date19.11.1992 "Per shoqerite tregtare";si dhe ne ligjin Nr.7667,date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", une DRITAN ZENELAJ i datelindjes 15.03.1974, lindur dhe banuese ne Koplik, Malesi e Madhe, dhe une NIKOLIN DEDVUKAJ i datelindjes 01.12.1957 lindur dhe banues ne Hot i Ri Shkoder THEMELOJME shoqerine "ALPIN " sh.p.k.

LLOJI I SHOQERISE

Kjo shoqeri do te jete "Shoqeri Tregtare" e formes "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (sh.p.k.)"

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e kesaj shoqerie do te jete PA AFAT.

EMERTIMI TREGTAR

Kjo shoqeri do te quhet " ALPIN "sh.p.k. Shoqeria ka dhe vulen e saj e rrethore ne te cilen shkruhet "Import-Eksport ALPIN sh.p.k.-Malesi e Madhe-Albania".

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te kesaj shoqerie eshte:

"Perpunimi, ambalazhimi dhe tregtimi me shumice ose pakice, import, eksport, i ujit.

Stacion te shitjes se karburantit (pike karburanti, distributor). Tregtimi me pakice, i hidrokarbureve, karburanteve dhe gazit natyrore per ngrohje, gatim dhe per lende djegese per automobilet si dhe te gazit te lenget.

Te gjitha llojet e projektiveve dhe punimeve te ndertimit te parashikuara per tu licensuar nga ministria e puneve publike, transportit dhe telekomunikacionit.(Emertimi i ministrise varion sipas ndryshimeve qe peson me vone).

Tregtimi me shumice e pakice, eksport-import te artikujve te ndryshem industrial (kancelari dhe artikuj shkollore, etj), i artikujve ushqimore, hidrosanitare, goma makinash, materiale ndertimi (si cemento, llaç, gelqere, hekur, pllaka, tjegulla, tulla, blloqe, skele, armatura e gjithçka qe lidhet me ndertimin), elektroshtepiake, elektrike, tekstile dhe konfeksione, makineri e paisje. Hapje rrobaqepsie.

Pastrim i mbeturinave inerte urbane, si dhe i plehrave te qytetit.

Prodhim e tregtim me shumice e pakice te konfeksioneve te ndryshme, te gatshme e gjysem te gatshme, blerjen e lendeve te para, ndihmese import-eksport, teknologji e paisje te konfeksioneve. Si dhe ambalazhimin dhe stampimin e tyre.

Tregtim te pjeseve te kembimit per autovetura, mjete transporti, atrecaure, tapiceri."

SELIA E SHOQERISE

Kjo shoqeri do te kete seline e vet ne adresen: Mosel, Reç, Koplik, Malesi e Madhe.

KAPITALI THEMELTAR


Shuma e kapitalit themeltar te kesaj shoqerie eshte 100.000. (Njeqindmije) leke te reja. Seicili nga ortakët zoteron 50 % te kapitalit themeltar dhe konkretisht:

- DRITAN ZENELAJ 50 % = 50.000. leke te reja.
- NIKOLIN DEDVUKAJ 50 % = 50.000. leke te reja.


ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqeria administrohet nga nje administrator i vetem i cili eshte ortaku

DRITAN ZENELAJ.
THEMELUESIT
DRITAN ZENELAJ



NIKOLIN DEDVUKAJ



Republika e Shqiperise
Zyra e Noterise Shkoder

Nr. Rep 257
Nr. Kol 105

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me daten 13.03.2006 ne zyren e Noterise Shkoder dhe para meje noterit se kesaj zyre Klement Radovani, u paraqiten personalisht kerkuesit e mesiperme dhe une pasi u sigurova per identitetin e tyre ne baze te dokumentave te tyre personal te identifikimit si dhe pasi u binda se kane zotesi te plote per te vepruar, vertetova nenshkrimet e mesiperme.

NOTERI
KLEMENT RADOVANI



STATUTI (I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR)

Duke u bazuar ne ligjin Nr. 7632,date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te kodit tregtar";ligjin Nr.7638,date19.11.1992 "Per shoqerite tregtare",si dhe ne ligjin Nr.7667,date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare une DRITAN ZENELAJ i datelindjes 15.03.1974, lindur dhe banuese ne Koplik, Malesi e Madhe, dhe une NIKOLIN DEDVUKAJ i datelindjes 01.12.1957 lindur dhe banues ne Hot i Ri Shkoder, me vullnetin tone te lire nenshkruajme kete statut.

FORMA E SHOQERISE NENI 1

Kjo shoqeri do te jete "Shoqeri Tregtare" e formes "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (sh.p.k.)" Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje te plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe ate Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nenligjore specifike per ushtrimin e saj, sipas objektit te veprimtarise se saj, mbi bazen e Aktit te Themelimi dhe Statutit te saj dhe normat e se drejtes tregtare nderkombetare.

KOHEZGJATJA NENI 2

Kohezgjatja e kesaj shoqerie do te jete PA AFAT, duke filluar ky afat nga dita e shpalljes se Vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per njohjen dhe regjistrimin e shoqerise si person juridik.
Me vendim te Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te shoqerise mund te ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Gjykates kopetente per te bere shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregtar.

EMERTIMI TREGTAR NENI 3

Kjo shoqeri do te quhet " ALPIN "sh.p.k. Shoqeria ka dhe vulen e saje rrethore ne te cilen shkruhet "Import-Eksport ALPIN sh.p.k.-Malesi e Madhe-Albania".

OBJEKTI I VEPRIMTARISE NENI 4

Objekti i veprimtarise ekonomike te kesaj shoqerie eshte:

"Perpunimi, ambalazhimi dhe tregtimi me shumice ose pakice, import, eksport, i ujit.

Stacion te shitjes se karburantit (pike karburanti, distributor). Tregtimi me pakice, i hidrokarbureve, karburanteve dhe gazit natyrore per ngrohje, gatim dhe per lende djegese per automobilet si dhe te gazit te lenget.

Te gjitha llojet e projekteve dhe punimeve te ndertimit te parashikuara per tu licensuar nga ministria e puneve publike, transportit dhe telekomunikacionit.(Emertimi i ministrise varion sipas ndryshimeve qe peson me vone).

Tregtimi me shumice e pakice, eksport-import te artikujve te ndryshem industrial (kancelari dhe artikuj shkollor, etj), i artikujve ushqimore, hidrosanitare, goma makinash, materiale ndertimi (si çimento, llaç, gelqere,

hekur, pllaka, tjegulla, tulla, blloqe, skele, armatura e gjithçka qe lidhet me ndertimin), elektroshtepiake, elektrike, tekstile dhe konfeksione, makineri e paisje. Hapje rrobaqepsie.

Pastrim i mbeturinave inerte urbane, si dhe i plehrave te qytetit.

Prodhim e tregtim me shumice e pakice te konfeksioneve te ndryshme, te gatshme e gjysem te gatshme, blerjen e lendeve te para, ndihmese import-eksport, teknologji e paisje te konfeksioneve. Si dhe ambalazhimin dhe stampimin e tyre.

Tregtim te pjeseve te kembimit per autovetura, mjete transporti, atrecature, tapiceri.”

SELIA E SHOQERISE

NENI 5

Kjo shoqeri do te kete seline e vet ne adresen: Mosel, Reç, Koplik, Malesi e Madhe.

KAPITALI THEMELTAR

NENI 6

Shuma e kapitalit themeltar te kesaj shoqerie eshte 100.000. (Njeqindmije) leke te reja.

Shoqeria cel llogari bankare ne leke vendi dhe cdo lloj valute, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shtetore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

Asambleja e Ortakeve dhe administratori i caktuar prej saj, depozitojne faksimilet e firmave të tyre orgjinale ne Bankat ku eshte celur llogaria .

NENI 7

Pjeset e kapitalit themeltar, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil dhe atij Tregtar.

Asambleja e Ortakeve ka të drejte të transferoj jashte territorit të Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e saj perfshire dhe fondet e Kontributet ne natyre.

Transferimet e pjeseve të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me akt noterial dhe per nje gje të tille ortaket duhet të marrin paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqeria dhe të trete duhet të respektojne keto transferime sapa tu behen të ditura.

NENI 8

Kapitali Themeltar i shoqerise mund të rritet ose zvogelohet, mbi bazen e vendimit me shkrim qe merr Asambleja e Ortakeve, i cili nenshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bere dhe shenimet ne regjistrin perkates.

Me vendim të Asamblese se Ortakeve ajo ka të drejten qe nje pjese të kuotave të kapitalit themeltar t'ja tjetersoje nje apo disa personave fizike jashte ortakerise ose personave juridike, vendas apo të huaj mbi bazen e aktit noterial, duke ju ceduar atyre dhe të drejten e qenies ortak ne raport me pjesen e kuotave të kapitalit të tjetersuar.

Cdo vendim i Asambleses e Ortakeve per ndryshimin e kapitalit themeltar i dergohet menjehere Gjykates kompetente qe e ka njohur dhe rregjistruar shoqerine si person juridik.

NENI 9

Secili nga ortakët zoteron 50 % të kapitalit themeltar dhe konkretisht:

- DRITAN ZENELAJ 50 % = 50.000. leke të reja.
- NIKOLIN DEDVUKAJ 50 % = 50.000. leke të reja.

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqërisë, behet para kërkesës së drejtuar Gjykatës për njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik.

NENI 10

Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen të treta teresisht ose pjesërisht, sipas ligjit.

NENI 11

Asambleja e Ortakëve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjithë kompetencat që ligji "Për shoqëritë Tregtare" i njeh asamblese së ortakëve.

Asambleja e Ortakëve mund t'ja delegojë kompetencat një ose me shumë Administratorëve të caktuar prej saj ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokurës.

NENI 12

Me vendim të Asamblese së Ortakëve shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë shtetit.

Organi vendimtar i Shoqërisë, Asambleja e Ortakëve, vendos:

1. Mbi ndryshimet në aktin e themelimit dhe statut.
2. Mbi formimin e filialeve, degeve dhe përfaqësive jashtë shtetit.
3. Mbi rritjen apo zvoglimin e kapitalit themeltar.
4. Mbi ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera.
5. Mbi transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar.
6. Mbi emerimin dhe revokimin e likuidatoreve.
7. Mbi mënyrën e operimit me mjetet financiare monetare.

Asambleja e Ortakëve kryesisht si dhe Administratori i emëruar prej tij dhe kur ky i fundit është i paisur me prokurë, ushtrojnë dhe keto të drejta:

Mundesohen për të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike që konsiderohen se janë të domosdoshme për ushtrimin e gjithanshëm dhe fitimprurës të veprimtarisë tregtare të shoqërisë sipas qëllimeve dhe objektivave të saj sic mund të jenë:

Të lidhin kontrata të ndryshme që kanë për objekt blerjen, shitjen, këmblimin, marrjen me qera të pasurive të ndryshme (të luajtshme apo të paluajtshme), si me persona fizikë dhe ata juridikë, vendas apo të huaj si dhe me shtetin dhe në rast të blerjes së pasurive të paluajtshme, të bëjnë dhe transkriptimin e pronësive së saj në favorin e tyre në Hipotekën e ZRPP, për të dokumentuar një rrethana të tillë dhe si shtesë të kapitalit në natyrë.

Të kryejnë çdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave private dhe shtetërore, Bankat e çdo niveli etj. që kanë të bëjnë me Garancitë, sipërmarrjet, marrjen e kredive, sigurimeve, transportit (brenda dhe jashtë shtetit), për zhdoganimin e mallrave të

importuara apo eksportuara, ate të plotesimit me korektese të dokumentacionit fiskal e tatimor etj. e shlyerjes ne kohe të cdo detyrimi. Ne rastet kur keto veprime juridike kryhen nga administratori , ne perfundim të realizimit të veprimit perkates detyrohet qe të njoftoje menjehere dhe t'i japin llogari ortakeve.

NENI 13

Shoqeria administrohet nga nje administrator i vetem i cili eshte ortaku DRITAN ZENELAJ.

NENI 14

Veprimet ekonomiko financiare të shoqerise, mbyllen me daten 31 Dhjetor të cdo viti. Per nxjerrjen e rezultatit kontabel të shoqerise, mbi bazen e aktivitet dhe pasivit ngarkohet nga Asambleja e Ortakeve nje ekspert kontabel i autorizuar.

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe kane.

NENI 15

Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bere me saktesi dhe duke respektuar të gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, qe jane të detyrueshme per tu zbatuar nga cdo subjekt privat, qe ushtron veprimtari tregtare.

NENI 16

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaket, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

NENI 17

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

NENI 18

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte krijuar sic mund të jene :
Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji “ Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare”
c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.
Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

NENI 19

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në Aneksin e Regjistrimit Tregtar.

NENI 20

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vemendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve të cilëve shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecantë apo personave fizikë apo juridikë vendas apo të huaj.

NENI 21

Cdo mosmarrveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, në të kundërtën çështjen mund të bëhet objekt konflikti gjyqësor në Gjykatën Kompetente.

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 22

Përsa nuk është shprehur në këtë statut, i referohet udhëzimeve plotësuese dhe të ligjshme të dhëna nga Asambleja e Ortakëve si dhe legjislativi në fuqi.

THEMELUESIT
DRITAN ZENELAJ
NIKOLIN DEDVUKAJ

Dritan Zenelaj
Nikolin Dedvukaj

Republika e Shqipërisë
Zyra e Noterisë Shkoder

Nr. Rep 257
Nr. Kol 105

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me datën 13.03.2006 në zyrën e Noterisë Shkoder dhe para meje noterit së kësaj zyre Klement Radovani, u paraqitën personalisht kërkuarët e mesipërme dhe unë pasi u sigurova për identitetin e tyre në bazë të dokumentave të tyre personal të identifikimit si dhe pasi u binda se kanë zotësi të plote për të vepruar, vertetova nënshkrimet e mesipërme.

NOTERI
KLEMENT RADOVANI

Klement Radovani

